



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe nenit 25.1 të Rregullores së punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës,

THËRRAS

Mbledhjen e III-të (tretë - mandati VIII) -e rregullt, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, e cila do të mbahet më **29 janar 2026, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në Komunën e Podujevës**, në orën **10:00**, dhe propozoj këtë;

REND TË DITËS

1. Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 29 dhjetor 2025
2. Raporti përmbledhës i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025
3. Propozim vendimi për formimin e Komisionit Ad-Hoc për hartimin e draft Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026
4. Propozim vendimi për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete
5. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendës drejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës
6. Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026
7. Të ndryshme

Nr.Prot.01-060/03-0004099/26
Podujevë, datë; 19 janar 2026





KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e II-të (dytë) -e rregullt, mandati VIII-të, e mbajtur më 29 dhjetor 2025.

Mbledhja filloi në orën 10:20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Fillimisht mbledhjen e hapi dhe deri në zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit e kryesoi z.Isak Ejupi në cilësinë e anëtarit më të moshuar të Kuvendit të Komunës, ndërsa pas zgjedhjes Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës z.Isak Shabani e kryesoi mbledhjen.

Në mbledhje të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Adelinë Stublla; Artrit Mulliqi; Fatri Zhitija; Kasib Bashota; Florent Hasani; Valdet Kamerolli; Arbrim Konushevc; Flandra Kadriu; Luljeta Muçolli-Azemi; Vlora Jashanica; Haki Rudari; Abedin Zeka; Avni Islami; Qëndresë Hajrizi; Ardi Hasani.

Nga LDK, Enis Shabani; Alisa Jetullahu; Enis Dërvisholli; Besim Latifi; Valdet Restelica; Blerta Azemi-Berisha; Valon Demolli; Ekrem Rrahmani; Ermal Osmani; Gresa Qosa-Maqastena; Arben Xhemajli; Arnisa Sylejmani; Isak Ejupi.

Nga PDK, Isak Shabani; Lulzim Pollomi; Mimoza Abdullahu; Rinesa Goxhufi.

Nga GUXO, Demokrat Hodolli.

Nga Unioni i Blakçorve, Gentrit Arifi.

Nga AAK, Baki Feta;

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës; z.Fahri Restelica Nënkrjetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Lirie Hoti Rama-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Saranda Stublla-Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Shuajb Blakçori-Drejtorja e Inspeksionit DI; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE)

Të pranishëm ishin edhe, përfaqësues media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

z.Isak Ejupi, Kryesues i mbledhjes, e hapi mbledhjen duke përshëndetur dhe duke i'u uruar mirëseardhje të pranishmëve në seancën e dytë të legjislaturës së VIII-të të Kuvendit të Komunës së Podujevës, theksoi, atëherë mund të fillojmë me seancën, të nderuar anëtarë/e të Kuvendit të Komunës, i nderuari Kryetar i Komunës, përfaqësues të mediave, për të kuptuar fillimisht kjo seancë është thirrur me rendin e ditës ku fillimisht do të bëhet dhënia e betimit të anëtarëve/eve të Kuvendit të cilët janë emëruar nga KQZ zëvendësues të ish anëtarëve të Kuvendit të cilët tash më janë emëruar në Ekzekutivin e Komunës, pastaj kemi zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës si pikë kryesore e kësaj mbledhje do të thoja, dhe në fund themelimi dhe përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pra thirrjen dhe materialin e kësaj mbledhje sigurisht e keni marrë me kohë dhe keni mund ta shqyrtoni, andaj sigurisht që pajtoheni të punohet me këtë rend të ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës, e pastaj të vazhdohet me shqyrtimin e temave të rendit të ditës, mirëpo paraprakisht Kryetari i Komunës ka kërkuar fjalën.

Vlen të theksohet se prezent janë të gjithë anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës, pra 35.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i mbledhjes e konsideron se mbështetet unanimisht të vazhdohet me punë.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, i respektuari Kryesues i mbledhjes, i respektuari Nënkyetar i Komunës, drejtor të Drejtorive komunale, asambleistë/e të Kuvendit, meqë në këtë format çfarë jemi sot është takimi i parë dhe unë vetëm sa për informacion të asamblesë deshta t'ju informoj se gjatë kësaj periudhe kohore nga inaugurimi i ri i organeve komunale kam arritur ta emërojë një pjesë të Ekzekutivit të Komunës, duke filluar nga Nënkyetari i Komunës z.Fahri Restelica i cili tani e tutje do ta kryej punën e Nënkyetarit të Komunës pra, pastaj i kam emëruar edhe drejtorët e: Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, Drejtorisë së Inspeksionit, Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, sigurisht po i shihni këta drejtor që janë ulur këtu përpara, prandaj ky ishte vetëm sa për informimin e juaj për të mos u krijuar ndonjë situatë të mundshme sa i përket emërimeve, kështu që tani e tutje këta të emëruar në kuadër të Ekzekutivit të Komunës do të kryejnë punën e tyre varësisht kompetencave dhe fushveprimtrive përkatëse që janë emëruar.

z.Isak Ejupi, Kryesues i mbledhjes, vazhdoi, pra edhe njëherë konstatoj se kuorum ka për të punuar sipas rendit të ditës dhe mund vazhdojmë pa vonesë.

Sa për rikujtimin e Juaj, deri në zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit, mbledhjet e Kuvendit të Komunës thirren dhe udhëhiqen nga asambleisti më i moshuar i Kuvendit dhe në këtë rast jam unë, prandaj vazhdojmë me pikat sipas rendit të ditës, mirëpo para se të fillojmë me punë, jam i njoftuar se prezent janë edhe 4 anëtarët e ri të Kuvendit të cilët janë zëvendësuar nga KQZ dhe tani vetëm duhet që të bëhet verifikimi i mandatit të tyre dhe dhënia e betimit, fjala është për anëtarët e ri Abedin Zeka, Avni Islami, Qëndresë Hajrizi dhe Ardi Hasani në vend të ish anëtarëve Bahri Selimi, Vigan Salihu, Lirie Hoti Rama dhe Avni Fetahu të emëruar në Ekzekutivin e Komunës ashtu siç e ceku edhe Kryetari i Komunës paraprakisht, mirëpo para se të vazhdohet me punë meqë është formalisht kërkesë që të deklaroheni nëse ndokush prej këtyre anëtarëve të rinj është më i moshuar se unë, ndërkohë që unë jam i lindur më 06.11.1960, ju lutem mund të deklaroheni, nëse jo atëherë vazhdohet me procedurën e paraparë.

- Dhënia e Betimit nga anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës, *Abedin Zeka, Avni Islami, Qëndresë Hajrizi, Ardi Hasani, zëvendësues të anëtarëve të cilët janë emëruar në kuadër të Ekzekutivit të Komunës Bahri Selimi, Vigan Salihu, Lirie Hoti Rama, Avni Fetahu)*

Kryesuesi i mbledhjes, vazhdoi, anëtarët e rinj të cilët u cekën pak më parë duhet të japin betimin dhe të nënshkruajnë deklaratën përkatëse, por paraprakisht kërkohet nga Komisioni për verifikimin e mandateve të administroj këtë çështje e pastaj të jepet betimi nga ana e anëtarëve të rinj të Kuvendit, prandaj lus Komisionin në fjalë në përbërje Artrit Mulliqi, Besim Latifi, Rinesa Goxhufi, të bëjnë administrimin e verifikimit të mandateve të 4 anëtarëve të rinj të Kuvendit të Komunës, dhe pastaj të dalin me një raport të shkurtër rreth kësaj çështje.

Nga Komisionit për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Kuvendit, në asistencë teknike të zyrtarit përkatës për punë të Kuvendit, bëhet verifikimi i mandateve të z.Abedin Zeka, z.Avni Islami, znj.Qëndresë Hajrizi dhe z.Ardi Hasani të cilët janë emëruar nga Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve si zëvendësues të ish anëtarëve të cilët janë emëruar në kuadër të Ekzekutivit të Komunës z.Bahri Selimi, z.Vigan Salihu, znj.Lirie Hoti Rama, dhe z.Avni Fetahu, dhe paraqitet njëkohësisht Raport, si në vijim;

znj.Rinesa Goxhufi, në emër të Komisionit për verifikimin e mandateve, duke përshëndetur të pranishmit, e paraqiti Raportin në fjalë, theksoi, në bazë të vendimeve të Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve konstatohet se z.Abedin Zeka emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Podujevë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit komunal z.Bahri Selimi, po ashtu z.Avni Islami emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Podujevë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit komunal z.Vigan Salihu, mandej znj.Qëndresë Hajrizi emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Podujevë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit komunal znj.Lirie Hoti Rama, si dhe z.Ardi Hasani emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Podujevë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit komunal z.Avni Fetahu.

Pra këto emërimet / zëvendësime janë bërë me vendime të veçanta të KQZ-së.

z.Isak Ejupi, Kryesues i mbledhjes, vazhdoi, dëgjua Raportin e Komisionit përkatës, tani ftoj z.Abedin Zeka, z.Avni Islami, znj.Qëndresë Hajrizi dhe z.Ardi Hasani, të ngritët në këmbë për dhënien e Betimit, unë e lexoj me zë tekstin në sekuenca kurse ju e përsëritni të njëjtin.

Me tekstin si në vijim:

Unë, _____ (duke theksuar secili emrin dhe mbiemrin e tij) _____, betohem se do t'i kryejë me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtrojë autorizimet e mia si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

Jepet betimi solemn dhe nënshkruhen deklaratat e betimit nga Abedin Zeka, Avni Islami, Qëndresë Hajrizi Ardi Hasani,

Rendi i ditës

z.Isak Ejupi, Kryesues i mbledhjes, theksoi, pra edhe njëherë konsideroj se thirrja e kësaj mbledhje së bashku me materialin përkatës ju është dërguar me kohë, andaj a pajtoheni të vazhdojmë me punë sipas rendit të propozuar të ditës, ju lutem deklaroheni me votim.

Pas votimit, u konstatua se Njëzëri me 35 vota PËR, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 01.12.2025

z.Isak Ejupi, Kryesues i mbledhjes, theksoi, sigurisht që këtë material e keni marrë me kohë dhe keni mund ta lexoni, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për ndonjë kërkesë për ndonjë plotësim apo ndryshim në këtë procesverbal, nëse jo e hedhë në votim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se Njëzëri me 35 vota PËR, miratohet Procesverbali nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 01.12.2025 sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

2. Zgjedhja e Kryesuesit/es të Kuvendit të Komunës së Podujevës

- *Ngritja e Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit*
- *Propozimi i kandidatëve*
- *Procesi i votimit*
- *Raporti i Komisionit për rezultatet e votimit*

z.Isak Ejupi, Kryesues i mbledhjes, theksoi, pra rreth kësaj mbledhje dhe lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, si pikë më sensitive, sipas proceduarave ligjore, fillimisht duhet të bëhet;

➤ **Ngritja e Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit,**

Komision ky i cili duhet të përbëhet së paku prej 3 anëtarëve dhe më së shumti prej 5 anëtarëve/eve, andaj në rrethanat dhe kushtet që ne funksionojmë e dëshirueshme do të ishte që ky Komision të formohet nga 3 anëtarë/e nga subjektet politike me numrin më të madh të përfaqësimit në këtë përbërje të Kuvendit, prandaj nëse nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën rreth formimit të këtij Komisioni, unë po e hedh në votim përbërjen e komisionit që të jetë prej 3 anëtarëve e që besoj se do të jetë funksional dhe më e pranueshme

Meqë nuk pati të interesuar për të marrë fjalën, apo propozime tjera, Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se unanimisht mbështetet propozimi që përbërja e Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit të jetë prej 3 anëtarëve, dhe atë nga tri subjektet me numrin më të madh të përfaqësimit në Kuvend.

z.Isak Ejupi, Kryesues i mbledhjes, vazhdoi, tani kërkoj prej subjekteve politike me numrin më të madh të anëtarëve/eve në Kuvendin e Komunës, të propozojnë nga një anëtar/e për këtë Komision, pra urdhëroni sipas radhës, nga LVV, pastaj LDK dhe në fund PDK.

z.Haki Rudari, theksoi, faleminderit i nderuari Kryesues i mbledhjes, të nderuar Kryetar dhe Nënkryetar i Komunës, Ekzekutiv i Komunës dhe shumë të respektuar kolegë nga të gjitha partitë politike, të dashur qytetarë, meqë është diskutimi im i parë në këtë përbërje të Kuvendit të Komunës së Podujevës dua t'ju uroj të gjithëve për këtë proces dhe këtë mandat katër vjeçar.

Sa i përket Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit, ne LVV propozojmë z.Fatri Zhitija.

z.Besim Latifi, theksoi, faleminderit i nderuar Kryesues i mbledhjes, anëtarë/e të Kuvendit, në emër të LDK-së, për anëtar në Komisionin në fjalë propozoj profesor z.Valdet Restelica.

z.Lulzim Pollomi, theksoi, përshëndetje të gjithëve, anëtarë/e të Kuvendit të Komunës, në emër të PDK-së propozoj znj.Mimoza Abdullahu për anëtare në Komisionin e cekur.

Kryesues i mbledhjes, theksoi, ju falënderoj shumë parafolësit për propozimet e paraqitura, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth kësaj çështje, nëse jo atëherë e hedh në votim ngritjen e Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Podujevës, sipas propozimeve të paraqitura.

Pas votimit, Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se Njëzëri me 35 vota PËR, mbështeten propozimet e paraqitura për anëtar/e në Komisionin në fjalë, respektivisht, ngritët Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Podujevës, në këtë përbërje: Fatri Zhitija-nga LVV, Valdet Restelica-nga LDK dhe Mimoza Abdullahu-nga PDK.

Komision i cili fillon punën menjëherë dhe ka mandat deri në kumtimin përfundimtarë të rezultateve të votimit, përkatësisht zgjedhjes së Kryesuesit/es të Kuvendit, dhe që ndër të tjera detyrë dhe përgjegjësi e tij është që të kujdeset për mbarëvajtjen e procesit të votimit, të bëjë numërimin e votave dhe t'i komunikoj rezultatet e votimit para anëtarëve të Kuvendit të Komunës, si dhe çështje tjera që ndërlidhen me procesin e votimit.

➤ *Propozimi i kandidatëve*

z.Isak Ejupi, Kryesues i mbledhjes, theksoi, sipas procedurës përkatëse, tani në radhë kemi propozimet për Kryesues/e të Kuvendit të Komunës së Podujevës. Sa për sqarim ju përkujtoj se sipas legjislacionit në fuqi, të drejtën e propozimit e kanë; -Subjektet politike në kuadër të përbërjes së Kuvendit, -Nismë qytetarësh, apo kandidat i pavarur i përfaqësuar në Kuvend, -Ndonjë grup i këshilltarëve apo një këshilltar.

Do të thotë që Kryesuesi i Kuvendit duhet të jetë nga përbërja e këtij Kuvendit mirëpo propozimet mund të bëhen në këtë formë, andaj urdhëroni mund të fillojmë me propozimet.

z.Haki Rudari, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LVV-së me përbërjen më të madhe prej 15 këshilltarëve të Kuvendit, në këtë përbërje të Kuvendit, nuk kemi kandidat për Kryesues të Kuvendit të Komunës, dhe kushdo qoftë që zgjedhët apo propozohet, ne vetëm i urojmë suksese.

z.Besim Latifi, theksoi, është paksa e habitshme apo ndoshta një lojë kjo e cila është pasi që krejt Podujeva e dinë për marrëveshjen e fshehtë të cilën e keni bërë, andaj mos bëni lojëra por vazhdoni me propozimin e juaj, nëse ju nuk keni propozim as ne nuk kemi propozim dhe vazhdojmë tutje.

z.Lulzim Pollomi, theksoi, i nderuar Kryetar i Komunës, Nënkyetar i Komunës, të nderuar anëtarë/e të Kuvendit Komunal, të nderuar qytetarë, zonja dhe zotërinj, duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale neni 41 nën-paragrafi 41.1, Statutin e Komunës neni 25, Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës neni 13 përkatësisht neni 14 paragrafi 14.1 nën-paragrafi b), në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, sot para juve po paraqesim kandidaturën për Kryesues të Kuvendit të Komunës së Podujevës të z.Isak Shabani, një emër i njohur dhe i dëshmuar në shërbim të vendit, qytetarëve dhe të Republikës së Kosovës.

z.Isak Shabani është veprimtar i çështjes kombëtare, ish bashkëpunëtor i ngushtë i Heroit Zahir Pajaziti, ish i burgosur politik dhe i mbijetuar i masakrës së Dubravës, duke bartur mbi vete sakrificën dhe përgjegjësinë morale të një brezi që kontribuoj drejtpërdrejt për lirinë që ne sot e gëzojmë. Pas liritimit nga burgu ai nuk u ndal në përkushtim dhe vullnet, vazhdoi dhe përfundoi studimet në fakultetin e mjekësisë duke dëshmuar se ndërtimi i vendit kërkon dije, profesionalizëm dhe përkushtim afatgjatë.

Në rrafshin institucional dhe profesional ka një përvojë të gjatë dhe shumë të respektuar, ai ishte për 17 vite zyrtar i lartë në Ministrinë e Shëndetësisë, 3 mandate asambleist komunal, dhe ish Deputet i Republikës së Kosovës, duke njohur në thellësi funksionimin e pushtetit lokal dhe atij qendrorë, dhe kjo përvojë e pasur e kombinuar me integritet personal, maturi politike dhe kulturë institucionale e bën zotëri Isak Shabanin një kandidat serioz dhe të denjë për funksionin e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Podujevës, një rol që kërkon unitet, respekt për Rregulloren, barazi për të gjithë asambleistët dhe përkushtim ndaj interesit publik.

Me bindje se Kuvendi Komunal ka nevojë për një udhëheqje të përgjegjshme, gjithëpërfshirëse dhe dinjitoze, kërkoj nga Ju që ta mbështetni zotëri Isak Shabanin si Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

z.Isak Ejupi, Kryesues i mbledhjes, meqë sipas Ligjit votimi për Kryesuesin e Kuvendit duhet të bëhet me vota të fshehta, atëherë do të ishte mirë që të mbajmë një pauzë dhe propozoj që të jetë për rreth 20 minuta në mënyrë që të përgatitet nga aspekti teknik materiali për votim, mirëpo paraprakisht pyes a ka ndonjë propozim tjetër për Kryesues Kuvendi, nëse jo atëherë ftoj Komisionin për mbarëvajtjen e procesit të votimit i cili u ngrit para pak qestesh që të mbledhet dhe koordinohet sa i përket procesit të votimit, ndërsa në qoftë se nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, shkojmë në pauzë për rreth 20 minuta.

Në propozim të Kryesuesit të mbledhjes, Kuvendi shkon në pauzë prej rreth 20 minuta (nga ora 10:45) për qëllim të përgatitjes së Fletëvotimeve dhe procedurave tjera sa i përket procesit të votimit për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit.

Pas pauzës, mbledhja vazhdoi në ora 11:15.

Në fillimin e vazhdimit të seancës prezent në sallë ishin 33 anëtar/e të Kuvendit, ndërsa pas disa minutave përbërja e Kuvendit të Komunës kompletohet duke qenë prezent të gjithë në sallë, pra gjithsej 35.

z.Isak Ejupi, Kryesues i mbledhjes, e hapi vazhdimin e mbledhjes, theksoi, sa për rikujtim edhe njëherë e theksoi që procesi i votimit është i fshehtë, ndërkohë që për tu zgjedhur në votimin e parë kandidati i propozuar për Kryesues i Kuvendit të Komunës duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të Kuvendarëve, do të thotë së paku votat Për, të 18 kuvendarëve.

Procesi i votimit, në raundin e parë, fillon duke u thirrur këshilltarët e Kuvendit emër për emër, të cilët nënshkruhen në listën e votimit, marrin fletëvotimin e vulosur për të votuar, votojnë dhe pas përfundimit të votimit, Komisioni paraqet raport.

Fjalën e ka kërkuar njëri prej anëtarëve të Komisionit përkatës, urdhëroni.

z.Fatri Zhitija, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, theksoi, ne si Komision kemi përgatit dokumentacionin procedural, e kemi listën e anëtarëve të Kuvendit, po ashtu janë shtypur dhe i kemi vulosur 35 fletëvotime për raundin e parë, kutin e votimit e kemi këtu si dhe vendin për votim në pjesën andej ku do të votohet, siç po e shihni, andaj konsiderojmë se çdo gjë është në rregull dhe mund të fillohet me procesin. Pra mund të fillojmë duke i thirrur me emra anëtarët/et e Kuvendit me radhë sipas listës përkatëse, të cilët nënshkruhen, marrin fletëvotimin e vulosur, shkojnë tek vendi për votim, dhe në fund e hedhin votën në kuti.

➤ **Procesi i votimit** (raundi i parë)

Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit (në përbërje z.Fatri Zhitija, z.Valdet Restelica dhe znj.Mimoza Abdullahu) fillon punën duke verifikuar fletëvotimet fillimisht, listën e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, pastaj duke thirrur emër për emër sipas radhës gjithë anëtarët/et e Kuvendit të cilët (përveç 13 anëtarëve/eve të subjektit politik LDK të cilët nuk morën pjesë fare në procesin e votimit), sipas radhës nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes në votim, marrin fletëvotimin e vulosur dhe votojnë me votim të fshehtë.

Pas votimit nga anëtarët/et që votuan, Komisioni fillon me punë sipas procedurave përkatëse ku fillimisht z.Fatri Zhitija në emër të Komisionit deklaroi se duke u bazuar në nënshkrimet e anëtarëve sipas listës përkatëse të cilët kanë votuar, nga 35 anëtar/e të Kuvendit sa janë gjithsej, 22 prej tyre kanë marrë pjesë në procesin e votimit, dhe në vijim vazhdohet duke hapur kutin e votim dhe tërhequr fletëvotimet, duke bërë numërimin e votave, dhe pastaj i njëjti paraqet;

- **Raport rreth mbarëvajtjes së procesit të votimit, dhe i njëjti komunikoi rezultatet e votimit.**

znj.Mimoza Abdullahu, në emër të Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit për Kryesues të Kuvendit të Komunës, e paraqiti Raportin në fjalë, theksoi, si Komision konstatojmë se prej 35 anëtarëve/eve të Kuvendit të Komunës së Podujevës, 22 prej tyre kanë marrë pjesë në procesin e votimit.

Nga 22 anëtarë/e të Kuvendit që kanë marrë pjesë në votim, 21 vota janë PËR. Kurse 1 votë është e PËRMBAJTUR, andaj me këtë rast zotëri Isak Shabanit i urojmë zgjedhjen Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës për këtë mandat 4 vjeçar.

z.Isak Ejupi, Kryesues i mbledhjes, theksoi, atëherë në bazë të Raportit të Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit dhe komunikimit të rezultatit të votimit në raundin e parë, konstatohet se me 21 vota PËR Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës në mandatin e VIII-të zgjedhet z.Isak Shabani, të cilin nga kjo foltore e uroj dhe i dëshiroj suksese dhe punë të mbarë si dhe njëkohësisht e ftoj që tani të marrë funksionin e Kryesuesit të Kuvendit.

Konstatim:

Nga 35 anëtarë/e të Kuvendit të Komunës së Podujevës, 22 prej tyre kanë marrë pjesë në procesin e votimit, prej tyre 21 vota janë PËR, 1 votë e PËRMBAJTUR, ndërsa 13 anëtar/e të Kuvendit nuk marrin pjesë në procesin e votimit, dhe nga ky rezultat Komisioni përkatës si dhe Kryesuesi i mbledhjes konstatuan se Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës zgjedhet z.Isak Shabani, i cili edhe nga ai moment merr Kryesimin e Kuvendit.

z.Isak Shabani, Kryesues i posa zgjedhur i Kuvendit të Komunës, pas marrjes së detyrës, e paraqiti fjalë rasti, theksoi, i nderuari Kryetar i Komunës z.Shpejtim Bulliqi, Nënkyetar i Komunës z.Fahri Restelica, i nderuari Kryesues i deritanishëm i mbledhjeve z.Isak Ejupi, drejtor të Drejtorive Komunale, të dashur asambleistë zonja dhe zotërinj, përfaqësues të mediave, të dashur qytetarë, së pari ju falënderoj sinjerisht për besimin e dhënë duke më zgjedhur Kryesues të Kuvendit të Komunës së Podujevës. Ky besim është nderë i madh për mua, por mbi të gjitha është përgjegjësi për të marrë këtë detyrë me përlusësi dhe seriozitet të plotë.

Dua të theksoj qartë se unë jam njëri nga ju, një asambleistë në mes asambleistëve, i barabartë në mendim, në përgjegjësi dhe në përkushtim ndaj qytetarëve që na e kanë dhënë mandatin.

Në ushtrimin e kësaj detyre dhe në përkushtim ndaj qytetarëve që na e kanë dhënë mandatin, në ushtrimin e kësaj detyre ju garantoj se do t'i respektoj të gjithë pa dallim, do ta respektoj Rregulloren e punës së Kuvendit, Statutin e Komunës së Podujevës si dhe të gjitha Ligjet dhe aktet juridike në fuqi.

Kuvendi duhet të jetë shembull i rendit, respektit institucional dhe debatit konstruktiv, është detyrë dhe e kuptoj si detyrë në shërbim ndaj qytetarëve dhe do të angazhohem maksimalisht që puna e këtij Kuvendi të jetë sa më transparente, ligjore dhe në interes të përgjithshëm. Çdo vendim dhe çdo akt që do ta nxjerrim dua të jetë në përputhje me Ligjin dhe në shërbim real të qytetarëve të Komunës tonë.

Paraprakisht ju kërkoj falje për çdo gabim të mundshëm nga ana ime sepse gabimet janë njerëzore, por njëkohësisht ju njoftoj se çdo sugjerim, rekomandim apo kritikë konstruktive për mbarëvajtjen e punës së Kuvendit dhe për shërbimin ndaj qytetarëve unë do ta shohë si vlerë dhe kontribut të përbashkët.

Besoj fuqishëm se vetëm me bashkëpunim dhe respekt të ndërsjellët dhe përgjegjësi institucionale mund ta bëjmë këtë Kuvend një zë të denjë për qytetarët që përfaqësojmë.

Përndryshe falënderoj edhe ata të cilët nuk më dhanë sot besimin, por mbi të gjitha jam një personalitet i tillë që i kuptoj edhe qëndrimet politike, pra faleminderit edhe prej Grupit të LDK-së, dhe faleminderit të gjithëve.

3. Themelimi i përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa

➤ *(Propozim vendimi për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa)*

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit të Komunës, vazhdoi, të nderuar/a siç e dini tani në rend të ditës tani me radhë kemi themelimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa-KPF, mirëpo paraprkisht ju lus që nëse ka mundësi përfaqësuesit e Grupeve të subjekteve politike të bëjmë një pauzë rreth 10 minuta në mënyrë që të kemi një konsultim paraprk sa i përket strukturës, përbërjes dhe përfaqësimit të KPF-së, materialin e keni marrë më herët kështu që besoj se me një takim konsultativ do të biem në dakord për përbërjen dhe përfaqësimin në KPF.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, fillimisht uroj kolegët të cilët nga sot kanë marrë mandatin e ri, po ashtu edhe ty i nderuar Kryesues të uroj dhe shpresoj që do të jesh bashkëpunues dhe që do të kontribuosh për Kuvendin e Komunës.

Arsyeja përse nuk votuam ne Grupi i LDK-së në procesin e zgjedhjes së Kryesuesit është sepse ndoshta është dashur që edhe neve por edhe qytetarëve t’ju tregohet që keni një koalicion, nuk është marre, edhe pse ne e dim që ky Grupi tjetër që ty të bëri Kryesues të Kuvendit për çdo ditë ka thënë që “ju jeni me Listën serbe, jeni kështu jeni ashtu”, dhe kjo është arsyeja pse është vazhgitë deri sot e që deri në ditën e fundit të mos zgjedhet Kryesuesi i Kuvendit, mirëpo nuk është marre të dilej paraprkisht të tregohet që kemi bashkëpunim dhe jemi marrë vesh se kush do të jetë Kryesues i Kuvendit, e ndoshta atëherë do të votonim edhe ne, por jo ne të vijmë në Kuvend dhe të mos dimë asgjë rreth kësaj çështje (pra edhe mu martu edhe martesë të jetë tinëz, nuk ka ashtu).

Kështu që i nderuar Kryesues i Kuvendit, për çdo gjë që është për qytetin dhe qytetarët e Komunës së Podujevës neve na ke mbrapa dhe shpresoj se do të kalojmë mirë.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, vazhdoi, siç e ceka pak më parë tani ju ftoj për një pauzë të shkurtër rreth 10 minuta këtu brenda hapësirave të Komunës dhe njëkohësisht ju ftoj në një takim në sallën numër 52 shifat ose përfaqësuesit e subjekteve politike për qëllim të konsultimeve rreth përbërjes së KPF-së, mirëpo edhe njëherë ju lus të qëndroni në hapësirat këtu në Komunë sepse pas rreth 10 minutave do të rikthehemi për të vazhduar besoj vetëm me propozimet dhe votimin e KPF-së, mirëpo paraprkisht meqë po kërkohet të ketë deklarime se kush janë shifat e Grupeve të subjekteve politike, atëherë urdhëroni mund t’i paraqitni.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, në emër të këshilltarëve të LVV-së, për shëf të Grupit e propozojmë z.Haki Rudarin.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, në emër të Grupit të LDK-së, shëf të Grupit e kemi profesor Besim Latifin.

znj.Mimoza Abdullahu, theksoi, nga PDK, shëf të Grupit e kemi z.Lulzim Pollomi.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, atëherë ju falënderoj dhe nga tani shkojmë në takimin e paralajmëruar me përfaqësuesit e subjekteve politike në Kuvendin e Komunës së Podujevës.

Në Kërkesë të Kryesuesit të Kuvendit, shkohet në pauzë për 10 minuta (ora 11:35) dhe atë për qëllim të konsultimeve me përfaqësuesit e subjekteve politike sa i përket përbërjes dhe përfaqësimit në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Pas pauzës, mbledhja vazhdoi në ora 11:50, konstatohet kuorumi ku prezent ishin të gjithë anëtarët/et e Kuvendit.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, vazhdoi, sa për njoftim ju them se nuk e di kush ka thënë që Grupet e këshilltarëve nuk merren vesh lehtë ngase ne shumë lehtë u morëm vesh për çështjen në fjalë për çka ju jam mirënjohës përfaqësuesve përkatës të subjekteve politike.

Mbi të gjitha ne u përcaktuam për përbërjen dhe strukturën e Komitetit për Politikë dhe Financa i cili do të jetë prej 9 anëtarëve, normal duke respektuar edhe përfaqësimin gjinor, e që në bazë të përqindjes së përfaqësimit në Kuvend, Grupit të LVV i takojnë 4 anëtar/e, Grupit të LDK-së 3 anëtar/e, Grupit të PDK-së 1 anëtar/e si dhe Kryesuesi i Kuvendit sipas pozitës zyrtare.

Prandaj meqë për këtë që e potencova patëm një dakordancë në takim, kalojmë me propozimet nga ana e subjekteve politike sipas radhës.

z.Fatri Zhitija, në emër të Grupit të LVV-së, për anëtar/e në përbërjen e KPF-së propozoi z.Haki Rudari, z.Artrit Mulliqi, znj.Adelinë Stublla dhe znj.Qëndresë Hajrizi.

z.Besim Latifi, në emër të LDK-së propozoi që në KPF të jetë znj.Alisa Jetullahu, z.Enis Shabani dhe z.Ekrem Rrahmani.

z.Lulzim Pollomi, në emër të PDK-së për anëtare në KPF e propozoi znj.Mimoza Abdullahu.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, atëherë unë po i lexoj emrat e propozuar (*lexon propozimet e bëra*), si dhe unë Isak Shabani në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit i cili sipas detyrës zyrtare është edhe Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj çështje, nëse jo atëherë e hedh në votim themelimin dhe përbërjen e KPF-së sipas propozimeve të paraqitura nga Grupet e subjekteve politike siç u cekën më lartë.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 35 anëtarë/e të Kuvendit, me 33 vota PËR, asnjë votë KUNDËR, asnjë votë e PËRMBAJTUR (2 anëtar nuk votuan), themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa, në këtë përbërje:

- 1. z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit (sipas pozitës)*
- 2. z.Haki Rudari, anëtar nga subjekti politik LVV*
- 3. z.Artrit Mulliqi, anëtar nga subjekti politik LVV*
- 4. znj.Adelinë Stublla, anëtare nga subjekti politik LVV*
- 5. znj.Qëndresë Hajrizi, anëtare nga subjekti politik LVV*
- 6. znj.Alisa Jetullahu, anëtare nga subjekti politik LDK*
- 7. z.Enis Shabani, anëtar nga subjekti politik LDK*
- 8. z.Ekrem Rrahmani, nga subjekti politik LDK*
- 9. znj.Mimoza Abdullahu, anëtare nga subjekti politik PDK*

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:55

Procesverbalin e mbajti dhe hartoi;
Enis Sheholli

Nr.Prot.01-060/04-0082936/25
Podujevë,
29 dhjetor 2025

Kryesuesi i mbledhjes
(Deri ne zgjedhjen e Kryesuesit)
Isak Ejupi

Kryesuesi i zgjedhur i Kuvendit
Isak Shabani



KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

RAPORT PËRMBLEDHËS

I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2025,

(përkatësisht deri në mbledhjen e fundit të legjislaturës VII të Kuvendit të Komunës më 29.09.2025)

Kuvendi i Komunës së Podujevës duke u bazuar në Planin e Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2025, procedimit dhe çështjeve të ndryshme nga Ekzekutivi i Komunës dhe varësisht nevojave të paraqitura si dhe në bazë nenit 40.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, paraqitet Raporti në vijim:

Kuvendi i Komunës së Podujevës gjatë kësaj periudhe ka funksionuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, ligjeve tjera të veçanta varësisht fushave përkatëse, akteve të tjera nënligjore, Statutit të Komunës së Podujevës si dhe Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Gjatë periudhës përkatëse vitit 2025, Kuvendi i Komunës së Podujevës ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje, prej tyre 7 të rregullta, 3 mbledhje solemne, si dhe 1 mbledhje komemorative, ndërsa që nga fillimi i këtij mandati 2021-2025 e deri më tani janë mbajtur 57 mbledhje të Kuvendit duke përfshirë edhe mbledhjen konstituive/inauguruese, në përputhje të plotë me nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, në të cilin ndër të tjera thuhet:

Neni 43

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

43.1 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës.

43.2 Kuvendi i Komunës mban së paku dhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, siç përcaktohet me Rregulloren e Punës.

43.3 Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftimin e tillë shkruhet:

- a) data e mbajtjes së mbledhjes;*
- b) koha e mbajtjes së mbledhjes;*
- c) vendi i mbajtjes së mbledhjes;*
- d) rendi i ditës për mbledhje; dhe*
- e) materialet e mbledhjes.*

f) të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Statut ose Rregullore të Punës.

43.4 Njoftimi dhe materialet e mbledhjes duhet të respektojnë Ligjin mbi Gjuhët. Injeksi njoftim duhet t'i shpallet publikut.

43.5 Njoftimi nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni duhet gjithashtu t'i dërgohet ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale.

Kuvendi i Komunës ka funksionuar duke marrë për bazë Planin e Punës për vitin 2025 por edhe çështje të propozuara e proceduara nga Ekzekutivi i Komunës si dhe çështje të përcaktuara nga Grupe të këshilltarëve të Kuvendit dhe anëtarë të Kuvendit të Komunës.

Në vijim paraqiten temat - çështjet e shqyrtuara në Kuvend, sipas mbledhjeve të mbajtura gjatë vitit 2025 dhe atë deri më 29.09.2025 duke u ndërlidhur me mandatin e VII të Kuvendit sikurse renditja në vijim sipas datave të mbledhjeve.

ÇËSHTJET E SHQYRTUARA NË KUVEND

Mbledhja e dyzetetëtë e mbajtur më 29.01.2025

1. Anulimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës nr. prot. 01-350/01-0050259/24 datë 31.07.2024 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishtëm në pjesën e poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1. *(Kjo pikë shtesë nga KPF)*
 2. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Objektivit Çerdhe Publike
 3. Raporti vjetor për vitin 2024 i Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A Podujevë
 4. Raporti i punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2024
- Pikat në vijim nuk janë shqyrtuar për shkak se mbledhja u ndërpre në mungesë të kuorumit*
5. Propozim Vendimi për kompensimin e anëtarëve të Komisioneve të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale Sh.A. Podujevë; NPL Stacioni i Autobusëve, NPL për Banim, NPL Eko-Llapi - *(Kjo pikë e bartur nga mbledhja e kaluar e Kuvendit)*
 6. Të Ndryshme

Mbledhja e dyzetënëntë e mbajtur më 17.02.2025 – Solemne ***(Për nder të ditës së shpalljes së Pavarësisë)***

1. Hapja e mbledhjes nga Kryesuesi i Kuvendit
 - Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
2. Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës së Podujevës
3. Fjalë rasti e përfaqësuesit të Organizatave të dala nga Lufta e UÇK-së - *(nuk kanë marrë pjesë)*

Mbledhja e pesëdhjetë e mbajtur më 05.03.2025 – Solemne ***(për nder të 27 vjetorit të Epopesë së UÇK-së)***

1. Hapja e mbledhjes nga Kryesuesi i Kuvendit
 - Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
2. Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës së Podujevës
3. Fjalë rasti e përfaqësuesit të Organizatave të dala nga Lufta e UÇK-së

Mbledhja e pesëdhjetenjë e mbajtur më 13.03.2025

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më:
11 dhjetor 2024; 30 dhjetor 2024; 29 janar 2025; 17 shkurt 2025.
2. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Objektivit Çerdhe Publike në fshatin Balloç
3. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare KRM “Pastrimi” Sh.A
4. Propozim Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB, për 2025
5. Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
6. Të Ndryshme

Mbledhja e pesëdhjetedy e mbajtur më 18.04.2025 **Vazhdimi i mbledhjes më 28.05.2025**

Dhënia e Betimit nga anëtarja e Kuvendit të Komunës së Podujevës znj. Donjetë Baliu

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të mbajtura më: 05.03.2025 dhe 13.03.2025
2. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2024 në vitin 2025 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore
3. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim për projektin e shpezëtarisë”
4. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim për pemëtarin”
5. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim me pajisje bletë”
6. Raporti vjetor financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024
7. Raporti financiar për periudhën janar-mars 2025
8. Propozim vendimi për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme publike komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të Ismet (Muharrem) Bulliqi

9. Propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa (emërimi i anëtarës së Komitetit për Politikë dhe Financa, në vend të znj. Drita Pajaziti e cila ka dhënë dorëheqje nga funksioni anëtare e Kuvendit të Komunës).

10. Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko Llapi" Sh.A. në Podujevë - (pikë shtesë nga KPF).

11. Të Ndryshme

Mbledhja e pesëdhjetetë e mbajtur më 28.05.2025

1. Draft Rregullore për Transparencë e Komunës së Podujevës

1.1. Draft Plani i Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2029

- Raporti për ecurinë e konsultimit publik për: Draft Rregullore për Transparencë e Komunën e Podujevës, dhe Draft Plani i Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2029

2. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit Ad-Hoc për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendës drejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës

3. Informatë për periudhën katër mujore të vitit 2025 - Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

4. Propozim vendimi - për ndryshim-plotësimi, përkatësisht riformulimin e të dhënave në kuadër të Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës nr. prot. 01-463/06-0078836 të datës 11 dhjetor 2024, dhe atë: E dhëna kadastrale e pronës, renditur në nr. 22 të Listës, konkretisht te Periudha kohore për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, ku thuhet Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër, riformulohet si vijon: Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë. - (Pikë shtesë nga KPF)

5. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës - Njësia kadastrale P-71712029-00202-3, në sipërfaqe 137157 m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm.

(Kjo Pikë shtesë nga KPF)

5.1. Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të kësaj prone. - (Pikë shtesë nga KPF)

6. Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik - 5 parcela në Pakashticë të Poshtme të ish Kooperativës Bujqësore nën menaxhimin e AKP-së - (Kjo Pikë shtesë në Kuvend)

7. Të ndryshme.

Mbledhja e pesëdhjetekatër e mbajtur më 19.06.2025 – Solemne

Për nder të Shënimit të 19 Qershorit - Ditës së Çlirimit të Podujevës.

- Intonimi i Himnit

1. Hapja e mbledhjes nga Kryesuesi i Kuvendit - Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

3. Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës së Podujevës

4. Fjalë rasti e përfaqësuesit të Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së

5. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Binjakëzimit me Qytetin AMES të Shtetit IOWA në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Mbledhja e pesëdhjetepesë e mbajtur më 26.06.2025

1. Korniza Afatmesme Buxhetore-KAB e Komunës së Podujevës, për vitet 2026/2028

2. Propozim vendimi për shpallje në interes të përgjithshëm publik - pronat e paluajtshme në ZK Metehi dhe Shtedim, Pronë Shoqërore Kooperative Bujqësore Kërpimeh, nën menaxhimin e AKP-së,

(Kjo Pikë shtesë në Kuvend)

3. Propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri

4. Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal Për Siguri Në Bashkësi-KKSB për 2024

5. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës nr. prot. 01-016/01-0022129/25 datë 18.04.2025 për ndryshim dhe plotësim të përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa - *Kërkesa e MAPL-së nr. 020-2/8 datë 30.05.2025.*

6. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës për 2024

- Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

7. Të ndryshme

Mbledhja e pesëdhjetëgjatë e mbajtur më 30.07.2025

- 1.Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të mbajtura më: 18 prill 2025 e vazhduar më 28 maj 2025; 28 maj 2025; 19 qershor 2025; 26 qershor 2025.
- 2.Raport i Monitorimit të Kontratave për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës (periudha e raportuar janar - qershor 2025) dhe Rekomandimet
- 3.Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri -Projekti “Furnizim me mëshqerra”
- 4.Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri -Projekti “Furnizim me makineri prodhuese për biznese
- 5.Kërkesat e MAPL-së për rishqyrtim të akteve të Kuvendit të Komunës, si në vijim:
5.1.Vendimi nr.prot.01-463/06-0029235/25 i datës 28.05.2025 (Shkresa e MAPL-së)
5.2.Vendimi nr.prot.01-463/06-0029237/25 i datës 28.05.2025 (Shkresa e MAPL-së)
5.3.Vendimi nr.prot.01-020/04-0029236/25 i datës 28.05.2025 (Shkresa e MAPL-së)
5.4.Rregullorja nr.prot.01-016/01-0029232/25 e datës 28.05.2025 (Shkresa e MAPL-së)
(Kjo Pikë 5.4. shtesë nga KPF)

Mbledhja e pesëdhjetëstë e mbajtur më 29.09.2025

Dhënia e Betimit nga anëtarë i Kuvendit të Komunës së Podujevës z.Avni Islami,

(i emëruar me Vendimin e KQZ nr.01/2319-2025 datë 03.09.2025)

- 1.Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 30 korrik 2025.
- 2.Propozim Vendimi për miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2026 dhe parashikimet buxhetore 2027-2028
- 3.Vendim për ndarjen e mjeteve financiare ndërmarrjes publike lokale-“Eko-Llapi”Sh.A, (Kjo Pikë shtesë në Kuvend)
- 4.Vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri -Projekti “furnizim me Pajisje për Blegtori” (Kjo pikë shtesë në Kuvend)
- 5.Të ndryshme

Nga mbledhjet e mbajtura në këtë periudhë kohore të vitit 2025, aktet e miratuara, janë:

NR	EMËRTIMI I AKTIT	NR. PROTOKOLLIT	DATA E MIRATIMIT
1	Vendim për anulimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-350/01-0050259/24 datë 31.07.2024 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1. - (Procedurë e Rishqyrtimit)	01-016/01-0006462/24	29.01.2025
2	Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe Publike në Podujevë (hapësira te shkolla “Enver Maloku)	01-016/01-0006464/25	29.01.2025
3	Vendim për miratimin e Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban i Komunës së Podujevës, për periudhën 2025 – 2029	01-016/01-0006466/25	29.01.2025
4	Vendim për caktimin e lokacioni për ndërtimin e objektit me destinim për Çerdhe Publike në fshatin Balloc Komuna e Podujevës	01-016/01-0015035/25	13.03.2025
5	Vendim për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike - KRM “Pastrimi” Sh.A	01-400/04-0015030/25	13.03.2025
6	Vendim për miratimin e Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025	01-016/01-0015041/25	13.03.2025
7	Vendim për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2024 në vitin 2025 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore	01-400/01-0022117/25	18.04.2025
8	Vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri -Projekti “furnizim për projektin e shpezëtarisë”	01-400/03-0022119/25	18.04.2025
9	Vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri -Projekti “furnizim për pemëtari”	01-400/03-0022121/25	18.04.2025
10	Vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri - Projekti “furnizim me pajisje për bletë ”	01-400/03-0022124/25	18.04.2025

11	Vendim - miratimi i këmbimit të pronës së paluajtshme publike komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Ismet (Muharrem) Bulliqi, <i>Projekti i ndërtimit të trotuarit në fshatin Llugë.</i>	01-463/06-0022127/25	18.04.2025
12	Vendim - Ndryshimi dhe plotësimi i përbërjes së KPF, Xhevdet Maloku, <i>emërohet anëtar në vend të znj.Drita Pajaziti e cila ka dhënë dorëheqje nga funksioni anëtare e Kuvendit të Komunës.</i>	01-016/01-0022129/25	18.04.2025
13	Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës NPL"Eko Llapi"sha në Podujevë (<i>ish parkingu para komunës së vjetër</i>)	01-461/01-0029110/25	28.05.2025 <i>Vazhd.i mbl. 18.04.2025</i>
14	Rregullore për transparencë e Komunës së Podujevës	01-016/01-0029232/25	28.05.2025
15	Vendim për miratimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2029	01-016/01-0029233/25	28.05.2025
16	Vendim për ngritjen e komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendës drejtorëve/shave në Institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës	01-020/04-0029234/25	28.05.2025
17	Vendim - ndryshim-plotësimi, përkatësisht riformulimi i të dhënave në kuadër të Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës - e dhëna kadastrale e pronës, renditur në nr.22 të Listës, konkretisht te Periudha kohore për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, ku thuhet <u>Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër</u> , riformulohet si vijon: <u>Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë</u> (<i>pikë shtesë nga KPF</i>)	01-463/06-0029235/25	28.05.2025
18	Vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës - Njësia kadastrale P-71712029-00202-3, në sipërfaqe 137157 m ² , ZK Lupç i Poshtëm (<i>pikë shtesë nga KPF</i>)	01-463/06-0029237/25	28.05.2025
19	Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës - Njësia kadastrale parcelë: P-71712029-00202-3, në sipërfaqe 13757 m ² , ZK Lupç i Poshtëm (<i>pikë shtesë nga KPF</i>)	01-020/04-0029236/25	28.05.2025
20	Vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm publik - 5 pronat e paluajtshme Shoqërore Kooperativa Bujqësore Kërprimëh, në Zonën Kadastrale Pakashticë e Poshtme Komuna e Podujevës, që janë nën menaxhimin e AKP. (<i>pikë shtesë drejtpërdrejt në Kuvend</i>)	01-463/06-0029239/25	28.05.2025
21	Vendim për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028	01-400/03-0036069/25	26.06.2025
22	Vendim për shpallje në interes të përgjithshme publik 3 prona paluajtshme Shoqërore Kooperativa Bujqësore, në Zonën Kadastrale Metehi Shtedim që janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit.	01-463/06-0036070/25	26.06.2025
23	Vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri - <i>Projekti "furnizim me mekanizëm bujqësor"</i>	01-400/03-0036072/25	26.06.2025
24	Vendim - Ndryshimi dhe plotësimi i përbërjes së KPF, Lirika Maliqi, <i>emërohet anëtare e KPF-së, në vend të znj.Drita Pajaziti e cila ka dhënë dorëheqje nga funksioni anëtare e Kuvendit të Komunës (Procedurë e Rishqyrtimit)</i>	01-016/01-0036075/25	26.06.2025
25	Vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri - <i>Projekti "Furnizim me mëshqerra"</i>	01-016/01-0044937/25	30.07.2025

26	Vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri - <i>Projekti "Furnizim me makineri prodhuese për biznese"</i>	01-016/01-0044940/25	30.07.2025
27	Vendim për anulimin e vendimit nr.prot.01-463/06-0029235/25 datë 28.05.2025 të miratuar nga Kuvendi (<i>Ndryshim plotësimi i Listë së veçantë të pronave për një pronë nga afatshkurtër në afatgjatë</i>) (<i>Procedurë e Rishqyrtimit</i>)	01-016/01-0044944/25	30.07.2025
28	Vendim për anulimin e vendimit nr.prot.01-463/06-0029237/25 datë 28.05.2025 të miratuar nga Kuvendi (<i>Miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë prona në Lupq</i>) (<i>Procedurë e Rishqyrtimit</i>)	01-016/01-0044965/25	30.07.2025
29	Vendim për anulimin e vendimit nr.prot.01-020/04-0029236/25 datë 28.05.2025 të miratuar nga Kuvendi (<i>Formim i komisionit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë pronën në Lupq</i>) (<i>Procedurë e Rishqyrtimit</i>)	01-016/01-0044971/25	30.07.2025
30	Rregullore për transparencë e Komunës së Podujevës <i>Procedurë e Rishqyrtimit</i>	01-016/01-0044979/25	30.07.2025
31	Vendim për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2026 dhe parashikimet buxhetore 2027-2028	01-400/01-0062888/25	29.09.2025
32	Vendim për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko-Llapi" Sh.A	01-400/03-0062887/25	29.09.2025
33	Vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri - <i>Projekti "furnizim me Pajisje për Blegtori"</i> .	01-400/03-0062890/25	29.09.2025

Nga numri i akteve të miratuara, janë publikuar 28 prej tyre, kurse 5 akte nuk janë publikuar për shkak të kërkesave të Ministrive përkatëse për rishqyrtim si dhe në mungesë të përgjigjeve të Ministrive sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë në procedurën e shqyrtimit administrativ të ligjshmërisë ashtu siç përcaktohet me dispozita ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA - KPF

Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë kësaj periudhe të vitit 2025 ka mbajtur gjithsej 7 mbledhje, prej tyre të gjitha të rregullta.

Komiteti për Politikë dhe Financa që nga themelimi dhe konstituimi në këtë legjislaturë ka shqyrtuar pothuajse të gjitha çështjet e propozuara për shqyrtim në Kuvendin e Komunës dhe për të njëjtat i ka rekomanduar Kuvendit sugjerime, propozime dhe ndryshime përkatëse, duke përfshirë pika shtesë apo edhe heqje të ndonjë pike / teme të planifikuar për shqyrtim në Kuvend varësisht nevojave, propozimeve dhe kërkesave të paraqitura.

➤ Në vijim paraqiten konstatimet e rekomanduara nga mbledhjet e KPF-së:

Më 28.01.2025 – KONSTATIME - të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit datë 29 janar 2025

Fillimisht në kërkesë dhe propozim të drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM, nga 7 anëtar/e të Komitetit sa ishin prezent në mbledhje me 4 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), mbështetet propozimi për përfshirjen si pikë shtesë në këtë mbledhje edhe:

-Kërkesa / Propozimi për anulimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-350/01-0050259/24 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në Pjesën e Poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1

1.Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Objektivit Çerdhe Publike -Njësëri me 7 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës.

2.Draft Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban i Komunës së Podujevës për vitet 2025-2029 - Njëzëri me 7 vota Për, Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës.

3.Raporti i punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 - Njëzëri me 7 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim të kësaj pike të rendit të ditës.

4.Raporti vjetor për vitin 2024 i Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A Podujevë -Njëzëri me 7 vota Për, Kuvendit i rekomandohet për diskutim të kësaj pike të rendit të ditës.

5.Propozim vendimi për kompensimin e anëtarëve të Komisioneve të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale Sh.A. Podujevë; NPL Stacioni i Autobusëve, NPL për Banim, NPL Eko-Llapi (pikë nga mbledhja e kaluar e Kuvendit) - Nga 7 anëtarët e Komitetit që ishin prezent në sallë, me 3 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të përmbajtur (3 anëtarë/e nuk mori pjesë në votim dhe 1 anëtar nuk mori pjesë në votim për shkak të konfliktit të interesit), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtimin e këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Kërkesa / Propozimi për anulimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-350/01-0050259/24 për inicimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në Pjesën e Poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1 -Nga 7 anëtarët e Komitetit që ishin prezent në sallë, me 5 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të përmbajtur (2 anëtarë/e nuk mori pjesë në votim), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për përfshirje në kuadër të rendit të ditës në mbledhjen e caktuar për datën 29.01.2025 dhe njëkohësisht shqyrtimin e kësaj Kërkesë/propozimi sipas materialit përkatës të prezantuar në mbledhjen e KPF dhe bashkëngjitur këtyre konstatimeve

Më 11.03.2025 - KONSTATIME -të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit më datë 13 mars 2025

1.Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Objektivit Çerdhe Publike në fshatin Balloc - Komuna e Podujevës - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

2.Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

3.Propozim Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB, për vitin 2025 - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes si dhe me rekomandim që në Planin përkatës të përfshihen edhe:

Në muajin korrik 2025 të parashihet të sjellët në Kuvendin e Komunës - Informatë e Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi KKSB, për gjashtëmujorin e parë të vitit.

Në muajin dhjetor 2025 të parashihet të sjellët në Kuvendin e Komunës - Informatë e Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi KKSB, për gjashtëmujorin e dytë të vitit.

Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

-Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 8 vota Për, 1 votë Kundër, dhe asnjë votë të Përmbajtur, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për diskutim të kësaj Informate sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Më 16.04.2025 -KONSTATIME -të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit më datë 18 prill 2025

1.Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Objektivit Çerdhe Publike në fshatin Balloc - Komuna e Podujevës -Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

2.Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh.A - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

3.Propozim Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB, për vitin 2025

- Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes si dhe me rekomandim që në Planin përkatës të përfshihen edhe:

Në muajin korrik 2025 të parashihet të sjellët në Kuvendin e Komunës - Informatë e Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi KKSB, për gjashtëmujorin e parë të vitit.

Në muajin dhjetor 2025 të parashihet të sjellët në Kuvendin e Komunës - Informatë e Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi KKSB, për gjashtëmujorin e dytë të vitit.

4.Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 8 vota Për, 1 votë Kundër, dhe asnjë votë të Përmbajtur, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për diskutim të kësaj Informatë sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Më 27.05.2025 - KONSTATIME -të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit më datë 28 maj 2025

Fillimisht, pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 6 vota Për, asnjë votë Kundër, 1 votë e Përmbajtur, nga anëtarët e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, mbështeten propozim vendimet e Kryetarit të Komunës të prezantuara nga drejtoresha e Drejtorisë së Pronës Kadastrale dhe Gjeodezisë, për futjen në rend të ditës në këtë mbledhje, si pika shtesë, dhe atë sipas materialit përkatës të prezantuar / shpërndarë në këtë mbledhje, dhe atë propozim vendimet si në vijim:

-Propozim vendim - ndryshim-plotësimi, përkatësisht riformulimi i të dhënave në kuadër të Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-463/06-0078836 të datës 11 dhjetor 2024, dhe atë: E dhëna kadastrale e pronës, renditur në nr.22 të Listës, konkretisht te Periudha kohore për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, ku thuhet Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër, riformulohet si vijon: Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë.

-Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës -Njësia kadastrale P-71712029-00202-3, në sipërfaqe 137157m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm

-Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të kësaj prone.

1.Draft Rregullore për Transparencë e Komunës së Podujevës

1.1.Draft Plani i Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2029

- **Raporti për ecurinë e konsultimit publik për: Draft Rregullore për Transparencë e Komunën e Podujevës, dhe Draft Plani i Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2029** - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se:

Nga 7 anëtarë/e të Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, me 3 vota Për, asnjë votë Kundër, 1 votë Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të Draft Rregullores për Transparencë e Komunës së Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Ndërsa,

Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të Draft Planit të Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2029, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

2.Propozim vendimi për ngritjen e komisionit Ad-Hoc për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendës drejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, me 6 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit sa

ishin prezent në sallë, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij propozim vendimi, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

3. Informatë për periudhën katër mujore të vitit 2025 - Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, me 7 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim të kësaj Informatë, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

4. Propozim vendimi - për ndryshim-plotësimi, përkatësisht riformulimin e të dhënave në kuadër të Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-463/06-0078836 të datës 11 dhjetor 2024, dhe atë: E dhëna kadastrale e pronës, renditur në nr.22 të Listës, konkretisht te Periudha kohore për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, ku thuhet Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër, riformulohet si vijon: Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë. -Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, me 7 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij propozim vendimi, sipas materialit përkatës të prezantuar / shpërndarë në këtë mbledhje, i cili është edhe pjesë përbërëse e këtyre rekomandimeve të KPF-së.

5. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës - Njësia kadastrale P-71712029-00202-3, në sipërfaqe 137157 m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm

5.1. Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të kësaj prone - Pas votimit, Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtyre Propozim vendimeve në këtë pikë të rendit të ditës, sipas materialit përkatës të prezantuar / shpërndarë në këtë mbledhje të KPF-së, i cili është edhe pjesë përbërëse e këtyre rekomandimeve.

Më 25.06.2025 -KONSTATIME -të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit datë 26 qershor 2025

1. Korniza Afatmesme Buxhetore – KAB e Komunës së Podujevës për vitet 2026 /2028

-Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se nga 8 anëtarë/e të Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, me 8 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim Korniza Afatmesme Buxhetore – KAB e Komunës së Podujevës për vitet 2026 /2028.

2. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 7 vota Për, 1 votë Abstenim dhe asnjë votë Kundër, nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në sallë, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim ky propozim vendimi, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

3. Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal Për Siguri në Bashkësi –KKSBB për vitin 2024 - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 6 vota Për, 2 vota Abstenim dhe asnjë votë Kundër nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim kjo Informatë, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

4. Rishqyrtim i Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-016/01-0022129/25 të datës 18.04.2025 për ndryshimin dhe plotësim të përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.

-Kërkesa e MAPL-së nr.020-2/8 datë 30.05.2025 - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, me 7 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim propozim vendimi

5. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës për 2024

-Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit - Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim, Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës për vitin 2024.

-Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Më 29.07.2025 - KONSTATIME -të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit datë 30 korrik 2025

Fillimisht në propozim të Kryesuesit të Kuvendit, Njëzëri mbështetet që në kuadër të Pikës 5 të përfshihet si pikë shtesë (5.4) edhe Kërkesa e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për rishqyrtimin përkatësisht harmonizimin e Rregullores për Transparencë e Komunës së Podujevës, sipas rekomandimit të Ministrisë përmes Shkresës përkatëse të prezantuar në këtë mbledhje dhe bashkëngjitur këtyre konstatimeve.

1.Raport i Monitorimit të Kontratave për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës (periudha e raportuar janar - qershor 2025) dhe Rekomandimet - *Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim të këtij Raporti, me ndryshim plotësimet e prezantuara nga drejtoresha e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, duke rekomanduar që këtyre konstatimeve t'i bashkëngjitet Raporti përkatës së bashku me plotësim ndryshimet e paraqitura.*

2.Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - Projekti “Furnizim me mëshqerra”

-Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se nga 9 anëtarë të Komitetit sa ishin prezent në sallë, me 5 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të Përmbytur (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

3. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - Projekti “Furnizim me makineri prodhuese për biznese - *Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

4.Kërkesat e MAPL-së për rishqyrtim të akteve të Kuvendit të Komunës, si në vijim:

4.1.Vendimi nr.prot.01-463/06-0029235/25 i datës 28.05.2025

4.2.Vendimi nr.prot.01-463/06-0029237/25 i datës 28.05.2025

4.3.Vendimi nr.prot.01-020/04-0029236/25 i datës 28.05.2025

4.4.-Rregullorja nr.prot.01-016/01-0029232/25 e datës 28.05.2025

-Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit, konstatoi se nga 8 anëtarë të Komitetit sa ishin prezent për momentin në sallë, me 4 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të Përmbytur, Kuvendit të Komunës i rekomandohet rishqyrtimi i tri vendimeve sipas kësaj pike të rendit të ditës, konform Kërkesave dhe rekomandimeve përkatëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, bashkëngjitur materialit të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

-Po ashtu, pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e Komitetit, Kuvendit të Komunës i rekomandohet rishqyrtimi, përkatësisht harmonizimi i Rregullores për Transparencë e Komunës së Podujevës të miratuar në mbledhjen e datës 28.05.2025, dhe atë sipas Kërkesës dhe rekomandimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal përcjellur përmes Shkresës e cila i bashkëngjitet këtyre konstatimeve

Më 26.09.2025 - KONSTATIME -të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit datë 29 shtator 2025

1.Propozim Vendimi për miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2026 dhe parashikime buxhetore 2027-2028 - *Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, me 8 vota Për nga anëtarët e Komitetit sa ishin prezent në sallë, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

Kuvendi i Komunës së Podujevës, përveç Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe Komitetit për Komunitete si trupa të përhershëm të Kuvendit, me qëllim të funksionimit sa më efikas të Komunës, ka të themeluara edhe Komitetet dhe Komisione/trupa tjera, ndër më të rëndësishmet:

-Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

-Komiteti për Barazi Gjinore

-Komiteti për Zhvillim Ekonomik

-Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale

-Komisionet Komunale të Aksionarëve të katër (4) Ndërmarrjeve Publike: (Kompania Regjionale e Mbeturinave-“Pastrimi” sh.a; Ndërmarrja Publike Lokale-Stacioni i Autobusëve Podujevë; Ndërmarrja Publike Lokale për Banim Podujevë; Ndërmarrja Publike Lokale-“Eko Llapi)

-Komisioni për koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e komunës së Podujevës.

-Anëtarët e caktuar përfaqësues të Komunës së Podujevës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës

-Komisione dhe trupa tjerë që kërkohen me legjislacionin në fuqi

Nr.Prot. 01-016/01-0076055/25
Podujevë, datë: 21.11.2025



VAZHDI I RAPORTIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS **- MANDATI I RI I KUVENDIT I FILLUAR NGA DATA 01.12.2025**

Me fillimin e mandatit të ri të Kuvendit të Komunës nga zgjedhjet lokale të mbajtura më 12 tetor 2025, ku konform certifikimit të rezultateve nga ana e KQZ, menjëherë janë ndërmarrë veprime në funksion të zbatimit të rezultateve të zgjedhjeve, dhe me këtë rast ftesa dhe rendi i ditës për mbledhjen inauguruese është bërë me kohë, brenda afateve dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, mbledhje e cila është mbajtur më 01 dhjetor 2025, dhe në të cilën në rend të ditës ndër çështjet procedurale që janë zhvilluar, është bërë dhënia e betimit nga anëtarët/et e zgjedhur të Kuvendit dhe dhënia e betimit nga Kryetari i zgjedhur i Komunës.

Më datë 29 dhjetor 2025 është mbajtur mbledhja e II-të e mandatit të ri të Kuvendit të Komunës, ku në atë mbledhje fillimisht është bërë betimi nga 4 anëtar/e të rinj të Kuvendit të Komunës duke zëvendësuar ish anëtarët përkatës të cilët janë emëruar në kuadër të Ekzekutivit të Komunës, mandej është zgjedh Kryesuesi i Kuvendit të Komunës si dhe është themeluar përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Çështjet e proceduara dhe trajtuara në Kuvend gjatë kësaj periudhe

Mbledhja e I-rë (inauguruese) e mbajtur më 01.12.2025

1. Hapja dhe kryesimi i mbledhjes nga anëtari më i moshuar i zgjedhur i Kuvendit
2. Ngritja e Komisionit për verifikimin e mandatit të anëtarëve të Kuvendit
- *Raporti i Komisionit për verifikimin e mandatit të anëtarëve të Kuvendit*
3. Dhënia e Betimit nga anëtarët/et e zgjedhur të Kuvendit të Komunës
4. Dhënia e Betimit nga Kryetari i Komunës
5. Fjala e rastit e Kryetarit të Komunës

Mbledhja e II-të e mbajtur më 29.12.2025

Dhënia e Betimit nga anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës, *(Zëvendësimi i ish anëtarëve të cilët janë emëruar në kuadër të Ekzekutivit të Komunës, konkretisht anëtarët e ri Abedin Zeka, Avni Islami, Qëndresë Hajrizi, Ardi Hasani në vend të ish anëtarëve Bahri Selimi, Vigan Salihu, Lirie Hoti Rama, dhe Ardi Hasani)*

1. Procesverbali nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 01.12.2025
2. Zgjedhja e Kryesuesit/ses të Kuvendit të Komunës së Podujevës
- *Ngritja e Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit*
- *Propozimi i kandidatëve*
- *Procesi i votimit*
- *Raporti i Komisionit për rezultatet e votimit*
3. Themelimi i përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa
➤ *(Propozim vendimi për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa)*

➤ **Përmbledhje statistikore të përgjithësuara nga të dhënat raportuese gjatë vitit 2025**

- **Mbledhje të Kuvendit:** Gjithsej 13 mbledhje, prej tyre Të rregullta 8; Solemne 3; Komemorativ 1; Inauguruese 1
- **Mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa:** 7 mbledhje të rregullta.
- **Akte të miratuara:** gjithsej 37, përfshirë edhe 4 aktet e nxjerra në mandatin e ri të Kuvendit të Komunës, si në vijim:

NR	EMËRTIMI I AKTIT	NR. PROTOKOLLIT	DATA E MIRATIMIT
34	Konkluzion - Themelimi i Komisionit për verifikimin e mandatit të këshilltarëve të Kuvendit të Komunës	01-311/05-0078546/25	01.12.2025
35	Konkluzion - Ngritja e Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit		29.12.2025
36	Vendim për Zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Podujevës	01-112/02-0082943/25	29.12.2025
37	Vendim për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa	01-016/01-0082947/25	29.12.2025

- Gjatë vitit 2025, nga numri i akteve prej 33 të miratuara nga legjislatura e kaluar, janë publikuar 28 prej tyre, kurse 5 akte nuk janë publikuar për shkak të kërkesave të Ministrive përkatëse për rishqyrtim si dhe në mungesë të përgjigjeve të Ministrive sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë në procedurën e shqyrtimit administrativ të ligjshmërisë ashtu siç përcaktohet me dispozita ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Ndërsa nga numri i akteve prej 4 të miratuara nga legjislatura aktuale pas zgjedhjeve të 12 tetorit 2025, ende nuk është publikuar asnjë prej tyre për shkak të procedurave dhe afateve ligjore të parapara sa i përket shqyrtimit administrativ të ligjshmërisë së akteve nga ana e Ministrive përkatëse, me theks Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Podujevë, janar 2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja d) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 13 paragrafi 1.2 të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, nenit 6 paragrafi 1.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, neneve 14, 15 paragrafi 2.3 dhe 34 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

Propozohet

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT AD-HOC PËR HARTIMIN E DRAFT PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2026

Neni 1

Me këtë vendim formohet komisioni ad-hoc për hartimin e Draft Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2023, dhe atë në këtë përbërje;

1. _____, kryesues i komisionit
2. _____, anëtar nga radhët e Kuvendit
3. _____, anëtar nga radhët e Kuvendit
4. _____, anëtar nga radhët e Kuvendit
5. _____, anëtar nga radhët e Kuvendit
6. _____, anëtar nga radhët e Kuvendit
7. _____, anëtar nga radhët e Kuvendit
8. _____, anëtar nga radhët e Ekzekutivit
9. _____, anëtar nga radhët e Ekzekutivit
10. _____, anëtar nga radhët e Ekzekutivit
11. _____, anëtar nga radhët e Ekzekutivit

Neni 2

Komisioni sipas këtij vendimi, përgatit draftin fillestar të Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024, organizon konsultime publike si dhe zhvillon të gjitha veprimet e nevojshme procedurale deri në hartimin final dhe procedimin në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Neni 3

Komisioni bashkëpunon dhe koordinon me Ekzekutivin e Komunës dhe shërbimet përkatëse në kuadër të Institucionit të Komunës së Podujevës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryesuesi i Kuvendit.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-020/04-0004090/26
Podujevë, Datë, 19.01.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS
Kryesuesi i Kuvendit

Në bazë të neneve 11, 51.1 dhe 53.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 13 pika 1.2 të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, nenet 7, 8 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, dhe neneve 14, 47 paragrafi 1, dhe nenit 49 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

Propozohet

V E N D I M
PËR THEMELIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

Neni 1

Kuvendit të Komunës së Podujevës i propozohet themelimi dhe përbërja e Komitetit për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në këtë përbërje:

1. _____, anëtar/e nga subjekti politik _____
2. _____, anëtar/e nga subjekti politik _____
3. _____, anëtar/e nga subjekti politik _____
4. _____, anëtar/e nga subjekti politik _____
5. _____, anëtar/e nga radhët _____
6. _____, anëtar/e nga radhët _____
7. _____, anëtar/e nga radhët _____
8. _____, anëtar/e nga radhët _____
9. _____, anëtar/e nga radhët _____

Neni 2

Mandati i anëtarëve të Komitetit sipas nenit 1 të këtij vendimi, ndërlihet dhe është në kohëzgjatje të mandatit të Kuvendit të Komunës, ndërsa ndryshimi dhe plotësimi eventual, bëhet me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës.

Neni 3

Komiteti për Komunitete, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë, Statutin e Komunës, Rregulloren e punës së Kuvendit, rregulloren e punës së Komiteteve, dhe dispozitat tjera përkatëse në fuqi.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-020/04-0003985/26
Podujevë, Datë, 19.01.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Isak Shabani



S q a r i m

Sa për njoftim dhe sqarim, në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, më datë 06 janar 2026 përmes Ftesës publike nr.prot.01-020/04-0000775/26, ashtu siç edhe parashihet në *Udhëzimin Administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë*, ndër të tjera kemi kërkuar nga Komunitetet jo shumicë që jetojnë në territorin e Komunës së Podujevës të bëjnë propozimet e tyre për anëtarë/e në Komitetin për Komunitete të Komunës së Podujevës, duke sqaruar edhe përbërjen, procedurat dhe çështje tjera relevante që ndërlidhen me Komitetet për Komunitete në Komuna.

Sipas neneve 8 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr.05/2020 *për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë*, Komitetit për Komunitete përbëhet, nga së paku një përfaqësues i secilit komunitet jo shumicë që jeton në Komunë, shumica e anëtarëve të Komitetit duhet të jetë nga komuniteti jo shumicë, zgjedhja e anëtarëve bëhet me propozimin e kandidatëve të propozuar nga komunitetet jo shumicë, ndërsa miratimi bëhet nga Kuvendi i Komunës. Kryesuesi i Komitetit zgjedhet nga vet Komiteti.



Formulari per kerkese apo ankese

Drejtorati/Njesia
Kuvendi Komunal

Data 13/01/2026

1. Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:

Emri dhe mbiemri

Drejtoria e Arsimit

Adresa e vendbanimit

Zahir Pajaziti

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

00000000

2. Mënyra e pranimi

Statusi i lëndës

Propozim

Ne proces

Numri personal

00000000

E-mail Adresa

Vlera për pagesë: 0.00

Mos shkruani në këtë pjesë

Numri i protokolit

01-020/04-0002552/26

Afati i zgjedhjes

12/02/2026

Vendimi

3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

Propozim vendim per themelimin e komisionit per zhvillimin e procedurave per perzgjedhjen e drektorve/zv drejtoreve

4. Dokumentet e bashkangjitura:

Nr. Lloji i dokumentit

5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë Drejtoria e Arsimit vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)

*Ju lutemi të kërkonit nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura

Pranuar nga: alban b.gashi



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Podujevës
Opština Podujevo – Municipality of Podujeva



Datë/a:	13.01.2026
Referenc-ë:	Zyrtare
Për/ Za/ To:	Asamblenë Komunale
CC:	
Nga/ Od/ From:	Avni Fetahu, Drejtor i DKA-së
Tema/ Subjekat/Subject:	Propozim vendim për themelimin e komisionit për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve/zv drejtorëve.



Të nderuar,

Duke u bazuar në Rregulloren nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, Kapitulli IV, neni 14, pika 8.1, Drejtori i Drejtorisë Komunale për Arsimit kërkon aprovimin tuaj për dy kandidatë për anëtarë të Komisionit përzgjedhës për drejtorë/zëvendësdrejtorë në institucionet edukativo-arsimore.

Kandidatët për Komision janë:

1. **Ma.sc. Blerim Vllasa** – Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë, i cili përfaqëson DKA-në;
2. **Bahrie Talla** – Drejtoreshë në ShFMU “Hyzyri e Samiu” në Letanc, anëtare e Komisionit.

Me këtë kërkesë konfirmoj se kandidatët e lartpërmendur i përmbushin të gjitha kriteret për të qenë anëtarë të Komisionit, në përputhje me Rregulloren nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar.



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E ARSIMIT

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores MAPL nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, ndërlidhur me nenet 62.3, 11, 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 5 shkronja d) të Ligjit nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nenit 14 paragrafi 8 nën-paragrafi 8.1 të Rregullores (QRK) nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, si dhe dispozitave të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

Propozohet

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E DREJTORËVE/SHAVE DHE ZËVENDËSDREJTORËVE/SHAVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE EDUKATIVO ARSIMORE TË KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

Me këtë vendim formohet Komisioni për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendësdrejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të komunës së Podujevës, në përbërjen si vijon:

1. **Blerim Vllasa**, zyrtar për arsimin e mesëm të lartë në Drejtorinë e Arsimit, kryesues
2. **Bahrie Talla**, drejtoresh në SHFMU "Hyzriu e Samiu" në fshatin Letanc, anëtare
3. _____ Përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, anëtar/e, i/e cili/a caktohet nga kjo Ministri.

Neni 2

Komisioni punët dhe detyrat i kryen në pajtim me dispozitat e Ligjit nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Rregullores (QRK) nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, si dhe dispozitave tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse që rregullojnë këtë fushë.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-020/04-0002552/26
Podujevë, datë, 13.01.2026

U.D. Drejtori

Avni Fetahu





Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës
Opština Podujeva / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 58 shkronja h), 14 dhe 17 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, neneve 13 dhe 8 paragrafi 3 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Rregulloren (QRK) 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenin 61 paragrafi 1.8, nenin 17 dhe 19 paragrafi 1.3 Statutit të Komunës së Podujevës Nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

Propozon
VENDIM

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË VEÇANTË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS QË PLANIFIKOHEN PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM GJATË VITIT 2026

Neni 1

Kuvendit të Komunës i propozohet për miratim Lista e veçantë e pronave të paluajtshme të Komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026.

Neni 2

Lista sipas nenit 1 të këtij vendimi, për secilën pronë, përmban, arsyetimin e interesit publik dhe zhvillimit ekonomik të Komunës, të dhënat kadastrale, qëllimin e dhënies në shfrytëzim, destinimin e pronës, parashikimin e kohës së publikimit të njohfimit dhe periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim të pronës përkatëse të paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Lista e veçantë e pronave të Komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026, përfshirë edhe Certifikatën pronësore, kopjen e planit dhe dokumentacionin tjetër të nevojshëm për secilën pronë.

Neni 4

Pas shqyrtimit dhe miratimit nga Kuvendit i Komunës, për zbatimin e këtij vendimi si dhe procedurave tjera të parapara me Ligjin nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, obligohet Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë në bashkëpunim dhe koordinim edhe me Drejtoritë tjera të Komunës varësisht fushveprimtarisë përkatëse.

Neni 5

Pas miratimit, Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021.

Nr.Pro: 01-463/06-0003410126
Datë: 15/01/2026
Podujevë

Kryetari i Komunës
Shpejtim Balliqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës
Opština Podujeva / Municipality of Podujeva



Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezi

LISTA E VEÇANTË E PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS QË
PLANIFIKOHEN PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM GJATË VITIT 2026

Nr.r	Të dhënat kadastrale të pronës	Arsyetimi i interesit publik dhe zhvillimit ekonomik	Data e publikimit të njoftimit	Periudha kohore për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës	Destinimi sipas Hartës Zonale Kadastrale
1	Paluajtshmëria e evidentuar në certifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-77153/2025 të datës: 27.11.2025 Njësia kadastrale P-00860-2 me sipërfaqe 29447 m², Kullosë me klasës 3 në vendin e quajtur "Bellasicë" dhe Njësia kadastrale P-00860-3 me sipërfaqe 26998 m², Arë e klasës 7 në vendin e quajtur "Bellasicë" Zona Kadastrale Revuq	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënie në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është shkurt-prill 2026	Njësitë kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë	Zonë Bujqësore

2	Paluajtshmëria e evidentuar në certifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-77153/2025 të datës: 27.11.2025 Lokalet afariste të cilat janë të ndërtuara në njësinë kadastrale P-00459-0 në Zonën Kadastrale Podujevë me sipërfaqe prej 2237 m² në “ Qytet, Rruga Skenderbeu” Lokalet të cilat janë të planifikuara të jepen në shfrytëzim janë: Lokali afarist me sipërfaqe 50m² Lokali afarist me sipërfaqe 55m²	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periodha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënien në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është shkurt – prill 2026	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër	Zonë Ndërtimore
---	--	--	---	---	------------------------

3	Paluajtshmëria e evidentuar në certifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-77153/2025 të datës: 27.11.2025 Njësia kadastrale P-00437-1 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Podujevë me sipërfaqe prej 231m² në vendin e quajtur “Qytet” Rruga Skenderbeu”. Siperfaqja e planifikuar për dhënien në shfrytëzim është 140m²	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënien në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është shkurt – prill 2026	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër	Q2P – B1 Zonë Ndërtimore
---	---	--	---	---	---

4	Paluajtshmëria e evidentuar në çertifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-77153/2025 të datës: 27.11.2025 Lokalet afariste të ndërtuara në njësin kadastrale P-536-0 në Zonën Kadastrale Podujevë konkretisht në njësin ku është i ndërtuar Stadiumi i Qytetit të Podujevës “Zahir Pajaziti” Lokali Nr.1 me sipërfaqe 60 m² Lokali Nr.2 me sipërfaqe 60 m² Lokali Nr.3 me sipërfaqe 60 m² Lokali Nr.4 me sipërfaqe 60 m² Lokali Nr.5 me sipërfaqe 60 m² Lokali Nr.6 me sipërfaqe 60 m² Lokali Nr.7 me sipërfaqe 60 m² Lokali Nr.8 me sipërfaqe 60 m² Lokali Nr.9 me sipërfaqe 60 m² Lokali Nr.10 me sipërfaqe 60 m² Lokali Nr.11 me sipërfaqe 120 m² Lokali Nr.12 me sipërfaqe 120 m²	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënie në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është Mars -Qershor 2026	Lokalet afariste planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër	Zonë Urbane
---	---	--	---	--	--------------------

5	Paluajtshmëria e evidentuar në certifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-77153/2025 të datës: 27.11.2025 Njësia kadastrale P-00594-0 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë me sipërfaqe prej 25397m² në vendin e quajtur "Fshati" me shfrytëzim aktual Mal me Klasë 6 Njësia kadastrale P-00596-0 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë me sipërfaqe prej 16214m² në vendin e quajtur "Fshati" me shfrytëzim aktual Tokë jo pjellore Njësia kadastrale P-00597-0 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë me sipërfaqe prej 768m² në vendin e quajtur "Fshati" me shfrytëzim aktual Livadh i Klasës 4 Njësia kadastrale P-00599-0 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë me sipërfaqe prej 1357m² në vendin e quajtur "Fshati" me shfrytëzim aktual Tokë Pyjore, Mal i Klasës 4	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënien në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është shtator-dhjetor 2026	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër	Zonë Pyjore
---	--	--	--	---	--------------------

6	Paluajtshmëria e evidentuar në certifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-77153/2025 të datës: 27.11.2025 Njësia Kadastrale P-02159-0 me sipërfaqe 24587 m², kullosë me klasë 4 në vendin e quajtur “Zllatushë425” në Zonën Kadastrale Batllavë	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënien në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është mars – qershor 2026	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër	Zonë Pyjore
7	Paluajtshmëria e evidentuar në certifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-77153/2025 të datës: 27.11.2025 Njësia kadastrale P-00425-1 me sipërfaqe 133555m², Arë e klasës 7 në vendin e quajtur “Bellasicë” Zona Kadastrale Zakut	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënien në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është mars-qershor 2026	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë	Zonë Bujqësore

8	Paluajtshmëria e evidentuar në certifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-77153/2025 të datës: 27.11.2025 Njësia kadastrale P-00429-0 me sipërfaqe 29380 m², Arë e klasës 6 në vendin e quajtur “Bellasicë” Zona Kadastrale Zakut	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënien në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është mars -qershor 2026	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë	Zonë Bujqësore
9	Paluajtshmëria e evidentuar në certifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-77153/2025 të datës: 27.11.2025 Njësia kadastrale P-00337-1 me sipërfaqe 136453 m², Arë me klasë 6 në vendin e quajtur “Nazuer” Zona Kadastrale Dobratin	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënien në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është shtator-dhjetor 2026	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë	Zonë Pyjore

10	Paluajtshmëria e evidentuar në certifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-77153/2025 të datës: 27.11.2025 Njësia kadastrale P-00337-2 me sipërfaqe 100677 m², Kullos me klasë 4 në vendin e quajtur "Nazuer" Zona Kadastrale Dobratin	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënien në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është shtator-dhjetor 2026	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë	Zonë Pyjore
11	Paluajtshmëria e evidentuar në certifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-82197/2025 të datës: 26.12.2025 Njësia kadastrale P-001541-1 me sipërfaqe 48840 m² dhe P-1541-2 me sipërfaqe prej 20000 Pronë Shoqërore Zona Kadastrale Podujevë ku nga këto dy njësi kadastrale jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 17478.68 m²	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënien në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është Prill - Qershor 2026	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër	Zonë e shërbimeve mërgje dhe komerciale

12	Paluajtshmëria e evidentuar në certifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-82197/2025 të datës: 26.12.2025 Njësia kadastrale P-001541-1 me sipërfaqe 48840 m² Pronë Shoqërore Zona Kadastrale Podujevë ku në shfrytëzim jepet shiperfaqja prej 2699.26 m²	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënien në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është Prill - Qershor 2026	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër	Zonë komerciale
13	Paluajtshmëria e evidentuar në certifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-77153/2025 të datës: 27.11.2025 Njësia kadastrale P-00704-0 dhe P-00706-0 me sipërfaqe 9937 m², Kullosë me klasë 2 në vendin e quajtur "Arë Nën Vorreza" Zona Kadastrale Llapashticë e Poshtme ku nga kjo sipërfaqe planifikohet të jepen në shfrytëzim 5500 m²	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënien në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është shkurt-prill 2026	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë	Njësia P-00704-0 Shfrytëzim i përzier prej 1870 m² dhe 3726 m² Zonë Bujqësore ndërs Njësia P-00706-0 Shfrytëzim i përzier prej 3863 m² dhe Zonë Bujqësore prej 485 m²

14	Paluajtshmëria e evidentuar në çertifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-77153/2025 të datës: 27.11.2025 Njësia kadastrale P-01273-0 me sipërfaqe 9421 m², “Tokë jo Pjellore” në vendin e quajtur “Djerrina” Zona Kadastrale Llapashticë e Epërme Njësia kadastrale P-01274-0 me sipërfaqe 185024m², Mal me klasë 3 dhe 4 në vendin e quajtur “Djerrina Rruga” Zona Kadastrale Llapashticë e Epërme	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënie në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është shtator-dhjetor 2026	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë	Zonë Pyjore
----	--	--	---	--	--------------------

15	Paluajtshmëria e evidentuar në çertifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-77153/2025 të datës: 27.11.2025 Njësia kadastrale P-00202-1 me sipërfaqe 44773m², Kullosë me klasë 4 në vendin e quajtur “Bugurdull” Zona Kadastrale Lupç i poshtëm Njësia kadastrale P-00202-2 me sipërfaqe 1908 m², Tokë jo pjellore në vendin e quajtur “Bugurdull” Zona Kadastrale Lupç i poshtëm	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periodha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënien në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është Mars - Qershor 2026	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë	Zonë Bujqësore
16	Paluajtshmëria e evidentuar në çertifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-77153/2025 të datës: 27.11.2025 Njësia kadastrale P-00202-3 me sipërfaqe 137157 m², Kullosë me klasë 4 në vendin e quajtur “Bugurdull” Zona Kadastrale Lupç i poshtëm	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periodha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënien në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është Mars - Qershor 2026	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë	Zonë Bujqësore

17	Paluajtshmëria e evidentuar në certifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-77153/2025 të datës: 27.11.2025 Njësia kadastrale P-00209-0 me sipërfaqe 38882 m², Kullosë me klasë 3 në vendin e quajtur “Bugurdull” Zona Kadastrale Lupç i poshtëm	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periodha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënien në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është Mars - Qershor 2026	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë	Zonë Bujqësore
